



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1237/ 10 prot.

Data 31 .07.2026

V E N D I M
Nr.902 /2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Ismail Shehu	Kryetar
Donika Daci	Anëtar
Edvin Simo	Anëtar

Në mbledhjen e datës 31.07.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.630/2026, datë 12.05.2026 për procedurën e prokurimit, “E hapur, e thjeshtuar” me nr. REF-82305-04-16-2026 me objekt “Prodhim, publikim dhe botim i materialeve promocionale”, me fond limit 7,454,401.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 28-04-2026, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “ALBDESIGN PSP” sh.p.k, NIPT L51819005Q, dhe adresë: Rruga Çerçiz Topulli , objekti Nr.17
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Shkodër, Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 – Shkodër
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar , Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 12.05.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.630/2026, ku vendosi:

- 1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “ALBDESIGN PSP” sh.p.k, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me nr. REF-82305-04-16-2026 me objekt “Prodhim, publikim dhe botim i materialeve promociionale”, me fond limit 7,454,401.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 28-04 2026, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.*
- 2. Të pranojë pjesërisht ankesën për operatori ekonomik “ALBDESIGN PSP” sh.p.k, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me nr. REF-82305-04-16-2026 me objekt “Prodhim, publikim dhe botim i materialeve promociionale”, me fond limit 7,454,401.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 28-04-2026, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.*
- 3. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet e DST sipas konstatimeve të KSHA dhe këtij vendimi për procedurën e mësipërme të prokurimit.*
- 4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.*
- 5. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “ALBDESIGN PSP” sh.p.k.*
- 6. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

I.2. Me shkresën nr. 11547/1prot., datë 21.05.2026, protokolluar me tonën nr1237/7 prot., datë 21.05.2026, autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër, njofton se ka bërë modifikimin e dokumentave të tenderit si dhe gjithashtu në vijim kërkon heqjen e pezullimit për procedurën objekt ankimi.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën nr. 11547/1prot., datë 21.05.2026, protokolluar me tonën nr1237/7 prot., datë 21.05.2026, autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër, njofton se ka bërë modifikimin e dokumentave të tenderit si dhe gjithashtu në vijim kërkon heqjen e pezullimit për procedurën objekt ankimi.

II.2. Nga verifikimi i sistemit elektronik, rezulton se autoriteti kontraktor ka modifikuar dokumentat standarte të tenderit si dhe gjithashtu i ka publikuar në sistemin elektronik.

II.3. Për sa më sipër, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor ka zbatuar vendimin Nr.630/2026, datë 12.05.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt ankimi “E hapur, e thjeshtuar” me nr. REF-82305-04-16-2026 me objekt “Prodhim, publikim dhe botim i materialeve promociionale”, me fond limit 7,454,401.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 28-04-2026, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1.Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me nr. REF-82305-04-16-2026 me objekt “Prodhim, publikim dhe botim i materialeve promociionale”, me fond limit 7,454,401.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 28-04-2026, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Donika Daci

Anëtar
Edvin Simo

Kryetar
Ismail Shehu